



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr 86, Datë 31.05.2019

MBI

MIRATIMIN E “MARREVËSHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” NËNSHKRUAR MIDIS “OSHEE” SH.A DHE “ReNRGY TRADING GROUP” SH.P.K

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20 gërma "h" të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, nenit 20 pika 1 të Marrëveshjes së sigurimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike dhe Furnizuesit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 24, datë 15.02.2017, ndryshuar me Vendimin nr.58, datë 15.04.2019, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me Miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërisë "OSHEE" sh.a dhe shoqërisë " ReNRGY TRADING GROUP " sh.p.k.

Konstatoi se:

- Shoqëria “OSHEE” sh.a me shkresën nr. 7711/3 Prot., datë 17.05.2019, protokolluar me tonën me nr.352 Prot, datë 20.05.2019, ka dërguar në ERE “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të nënshkruar midis "OSHEE" sh.a dhe " ReNRGY TRADING GROUP " sh.p.k me datë 17.05.2019, me qëllim miratimin nga ERE të kësaj marrëveshje në zbatim të Vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 24, datë 15.02.2017, "Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE Sh.a dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.04.2019.
- ERE me Vendimin e Bordit nr.245, datë 26.11.2018 , ka licensuar shoqërinë “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr.96, datë 27.10.2014 ka licensuar shoqërinë “Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike” sh.a në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë

elektrike”, për një afat 30-vjeçar, i ndryshuar me vendimin nr.216, datë 11.10.2018 dhe me vendimin nr.264, datë 20.12.2018.

- Në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s sa më sipër cituar nr.24, datë 15.02.2017 “*Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe furnizuesit të energjisë elektrike*”, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.04.2019 është parashikuar në nenin 20, pika 1 të saj përcaktohet se, “*Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE dhe piken 20.2 se, Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj Marrëveshje bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.*”
- Në lidhje me përmbajtjen e kësaj marrëveshje, e nënshkruar dhe e dakortësuar mes palëve, konstatojme se kanë reflektuar të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen TIP të cilën e ka miratuar dhe ndryshuar se fundmi me vendimin nr.58, datë 15.04.2019.
- Marrëveshja është hartuar në përputhje me aktin e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr.24, datë 15.02.2017, “*Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe furnizuesit të energjisë elektrike*”, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.04.2019.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE:

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për “Miratimin e marrëveshjes për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nr.7711/3 Prot, datë 17.05.2019 nënshkruar midis shoqërisë "OSHEE" sh.a dhe shoqërisë " ReNRGY TRADING GROUP " sh.p.k.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI

